



**MEMORANDUM MIRËKËPTIMI**  
**NDËRMJET**  
**AKADEMISË SË LONDRËS PËR DIPLOMACI – UNIVERSITETIT TË ANGLISË**  
**LINDORE, KAMPUSIT NË LONDËR, MBRETËRI E BASHKUAR**  
**DHE**  
**AKADEMISË DIPLOMATIKE TË**  
**MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS<sup>1</sup>**

**Hyrje**

Akademia e Londrës për Diplomaci dhe Akademia Diplomatike e Kosovës shprehin synimin e tyre, që në parim, të lehtësojnë dhe zhvillojnë marrëdhënie kuptimplota dhe reciprokisht të dobishme dhe të nxisin zhvillimin e aktiviteteve të reja bashkëpunuese për vitet vijuese.

Hollësitë e çfarëdo dispozite të mëtejshme të bashkëpunimit do të evidentohen në memorandumit e njohjes që do të dakordohet nga të dy institucionet, duke specifikuar kurset akademike dhe marrëveshjet administrative dhe financiare të ofrimit të bashkëpunimit.

**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas miratimit nga të dyja palët. Ajo do të jetë valide për një periudhë fillestare prej tre vitesh. Në qoftë se pajtohen të dy institucionet, marrëveshja do të përtërihet për një periudhë shtesë prej tre vitesh pas shkëmbimit zyrtar të letrave. Ky proces do të përdoret për ripërtëritje të marrëveshjes për secilën periudhë tre-vjeçare.

**Përfundimi**

Secila palë mund ta përfundojë marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet njoftimit paraprak me shkrim prej së paku gjashtë muajve.

---

<sup>1</sup> KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGINALE!

Nënshkruar:

Profesor Nabil Ayad  
Rektor  
Akademia e Londrës për Diplomaci  
Universiteti i Anglisë Lindore, Kampusi në  
Londër

Data: 26 Maj 2012

Nënshkruar:

Shkëlqesia e tij Dr. Ibrahim Gashi  
Zëvendësministër  
Akademia Diplomatike e  
Kosovës  
Ministria e Punëve të  
Jashtme  
Ndërtesa e re e Qeverisë  
10000, Prishtinë  
Kosovë

Data: 26 Maj 2012